

Skender Asani, PhD¹

UDC: 342.72/.73:342.565.2(497.7)

**ÇËSHËTJA SHQIPTARE NË VITET E PARA TË MBRETËRISË
SKS (1919-1921)**

**АЛБАНСКОТО ПРАШАЊЕ ВО ПРВИТЕ ГОДИНИ НА
КРАЛСТВОТО СХС (1919-1921)**

**THE ALBANIAN ISSUE IN THE FIRST YEARS OF THE
KINGDOM OF SCS (1919-1921)**

Abstract

The Kingdom of SCS was one of the most complicated of the new states of Eastern and Central Europe in the period between the two world wars. It was composed of a large number of territorial units and nations from before 1918.

The Kingdom of SCS was a transmitter of Russian policy in the Balkans, which ensured its support. The creation of the Greater Serbia project was related to the increasing influence of Russian politics in the Balkans. This policy helped Nikola Pashiq to strengthen and realize the Serbian idea. This enabled the Kingdom of SCS to present itself as a dominant power in relation to its neighbors, which enabled it to have political stability and show appetites for territorial expansion. On the other hand, the great powers wanted to strengthen their dominance in the Balkans through the Kingdom of SCS.

Half of the Albanian people remained within this kingdom, spread over the territory of Kosovo, Macedonia, and Montenegro. But the Macedonian people also remained under this kingdom, which was also deprived from many ethnic-national rights.

¹ Autori është doktor i shkencave historike, këshilltar shkencor/profesor i rregullt në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.
Email: skendershkupi1@hotmail.com

The Kingdom of SCS tried to reduce the number of the Muslim population in various ways, and at the same time to break the ethnic and religious unity in its territories. For those reasons, drastic measures of an economic, social and political nature have been undertaken, such as colonization, assimilation and violent expulsion. For this reason, the Serbian political elites decided to realize their aspirations by deporting thousands of Muslim Albanians to Turkey. At the same time, the Serbian political elites began to implement the "agrarian reform" in order to colonize the Serbs and Montenegrins in the northeastern Albanian territories.

Keywords: *The Kingdom of SCS, agrarian reform, colonization, Xhemijet*

Hyrje

Ngjarjet e mëdha historike asnjëherë nuk kanë ndodhur për shkaqe të vogla dhe asnjëherë nuk kanë mbetur pa pasoja të mëdha. Lufta e Parë Botërore në Evropë dhe reperkusionet nga ajo, u ndjenë në një periudhë më të gjatë kohore, gjatë së cilës u rrëzuan disa qeveri, shtete, dhe u tejkaluan shumë paragjykime. Me ndryshimin e hartës së Evropës, u ndryshua edhe psikologjia shoqërore, ndodhi rënia ekonomike dhe financiare, dobësim i besimit në institucione, duke i hapur rrugën ndryshimeve dhe mundësive të reja². Përskaaj pasojave të rënda në sferën ekonomike, pas përfundimit të luftës, rrethanat historike për formimin e Mbretërisë SKS ishin të përshtatshme, për shkak të pjesëmarrjes në Luftën e Parë Botërore në krahun e Antantës, e gjithashtu edhe për shkak të lidhjeve tradicionale me disa shtete evropiane (Francën, Britaninë e Madhe, Rusinë, etj.). Formimi i Mbretërisë SKS në mënyrë indirekte u ndihmua edhe nga disa fuqi të mëdha, siç ishte Franca dhe Rusia³.

Mbretëria SKS ishte transmetuese e politikës ruse në Ballkan, me çka edhe e siguroi përkrahjen e saj. Krijimi i projektit Serbia e Madhe, ishte në ndërlidhje me rritjen e ndikimit të politikës ruse në Ballkan. Kjo politikë i ndihmoi Nikolla Pashiqit, që ta forcojë dhe realizojë idenë serbomadhe⁴. Kjo mundësoi që Mbretëria SKS në Ballkan të paraqitet

² Два покрета, "Мисао" (Књижевно-политички часопис), Београд, 1919, 141.

³ Dragoslav Janković, Stvaranje jugoslovenske države 1914 - 1958, Beograd, 1962, 1-8.

⁴ Sekula Draljević, Balkanski sukobi 1905-1941, Zagreb, 1944, 96.

si fuqi që dominonte në raport me fqinjët, çka i mundësoi që të ketë stabilitet politik dhe të tregojë apetite për zgjerim territorial. Në anën tjetër, fuqitë e mëdha përmes Mbretërisë SKS, dëshironin që ta forcojnë dominimin e tyre në Ballkan.

Në bazë të të gjitha kriterëve: historike, traditës politike, standardit politiko-ekonomik, sistemit legal, fesë dhe kulturës, Mbretëria SKS ishte më e komplikuar nga shtetet e reja të Evropës Lindore dhe Qendrore në periudhën në mes dy luftërave botërore. Ajo ishte e përbërë nga një numër i madh i njësive territoriale dhe popujve prej para vitit 1918. Nga gjysma austrohungareze e ish perandorisë së Habsburgëve, Mbretëria SKS i trashëgoi Sllavoninë dhe Dalmacinë, Kroacinë, Slloveninë, rajonin e Vojvodinës, provincën e Bosnjës e Hercegovinës dhe trevat verilindore (Maqedoninë e sotme, Kosovën dhe Sanxhakun), të cilat ishin territore osmane deri në luftërat ballkanike të viteve 1912 dhe 1913.

Rrethanat shoqërore-politike

Themelimi i Mbretërisë SKS dhe veçanërisht pozita e saj e favorshme në marrëdhëniet ndërkombëtare, kishte disa përparësi menjëherë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Në këtë periudhë, në rend dite ishte vënë çështja e njohjes ndërkombëtare e shtetit të ri, për shkak se si subjekte në marrëdhëniet ndërkombëtare, legjitimitet kishin vetëm se Mbretëria e Serbisë dhe Mbretëria e Malit të Zi. Akti i themelimit më 1 dhjetor 1918, nuk solli në mënyrë automatike njohjen ndërkombëtare të shtetit të ri, Mbretërisë SKS. Njohja ndodhi në periudhën e parë të vitit 1919, kur filluan ta njohin fuqitë e mëdha botërore. Njohja e parë erdhi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, derisa Franca dhe Britania e Madhe, për shkak të Italisë, e cila nuk dëshironte që të formohej shteti i ri i Mbretërisë SKS, një periudhë taktizuan rreth njohjes së tij⁵.

Në Mbretërinë SKS hynë edhe dy, deri atëherë shtete të pavarura: Mbretëria e Serbisë dhe Mbretëria e Malit të Zi⁶. Mbretëria e Serbisë do ta luajë rolin e piemontit ku do të bashkoheshin sllavët e jugut në një shtet, dhe do të krijonin Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve.

⁵ Мита Димитријевић, Ми и Хрвати 1914 - 1939, Београд, 1939, 102-106; Меѓународни научни скуп Великих силе и Србија пред први светски рат, одржан 13 -15 септембра 1974, Српска Академија Науке и Уметности, Научни скупови, књ.ІV, одељење историјских наука, књ.1, Београд, 1976, 843.

⁶ Joseph Rothschild, East Central Europe between the Two World Wars, Washington, 1974, 199.

Ndasitë në mes të fuqive të mëdha dhe shteteve të vogla, në asnjë ngjarje tjetër nuk ishin më të thella dhe më të shprehura, sikurse në Konferencën Paqësore të Versajës në Paris, me të cilën përfundoi Lufta e Parë Botërore. Konferenca e paqes ishte ngjarja më e madhe botërore, kurse paqësorët, me të drejtë u llogaritën si njerëzit më të fuqishëm. Ata argumentuan, debatuan, dhe pas debatit lehtë u morën vesh⁷. Sipas të gjitha anketave të kohës, Konferenca e Paqes së Versajës, vlerësohej si konferenca më e madhe deri në atë kohë, e cila mblodhi në një vend diplomatë, politikanë dhe burrështetas.

Katërbëdhjetë kërkesat e Uilsonit, ishin një shpresë e re, të cilat e rrënuan sistemin dhe konceptin e vjetër politik dhe social, që ishte i bazuar në udhëheqjen e më të fortit; u hapën perspektivat për popujt më të vegjël, që edhe ata të kenë të drejtën legjitime të lirive dhe të drejtave kombëtare dhe fetare. Kryetari Uilson, përmes 14 pikave, pretendonte të sjell një program për një moral të ri në politikën botërore⁸. Insistimi i tij për vetëvendosje ishte në kundërshtim me të gjitha përpjekjet e bëra në Konferencën e Paqes në Paris⁹. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kryetari i saj u angazhuan për një rend të ri botëror, ku do të dominonte demokracia, siguria kolektive dhe e drejta e popujve për vetëvendosje.

Duket se ideja e madhe për lirinë e popujve dhe shteteve, të cilën e proklamonte kryetari Uilson, politika shtetërore e Mbretërisë SKS, gradualisht filloi ta eliminojë. Elita politike vetëm në mënyrë deklarative promovonte këto vlera si universale dhe të obligueshme për çdo popull i cili takon civilizimit, veçanërisht pas një lufte të ashpër dhe shkatërruese¹⁰.

Këto rekomandime nuk kishin të bëjnë me traktatin e Sënt Zhermenit vetë, por me konventën aneks që e rregullonte mbrojtjen e minoriteteve. Aty nuk precizohej se si do të plotësoheshin dëshirat e serbëve, kroatëve dhe sllovenëve. Pa folur për çështjen e Adriatikut që josh si sllovenët, ashtu edhe kroatët, në komisionet e ndryshme të Konferencës konstatohej se vendi i serbëve është shkatërruar plotësisht dhe se

⁷ Margaret Macmillan, Paris 1919 (Gjashtë muajt që ndryshuan botën), Tiranë, 2006, 21.

⁸ Austro-Hungaria kërkonte marrëveshje paqësore duke u mbështetur në 14 pikat e propozuara nga kryetari i SHBA-ve, U. Uilson; Svetozar Pribičević, Diktatura Kralja Aleksandra, Beograd, 1953, 31; Јов. М. Јовановић, Стварење зајеничке државе Срба, Хрвата и Словенаца, Београд, 1930, 105 – 108; Dragoslav Janković, Stvaranje jugoslovenske države 1914 - 1958, Beograd, 1962, 1 – 8; Lush Culaj, Çështja shqiptare në Konferencën e Parisit 1919 – 1920, Prishtinë, 2010, 351.

⁹ Stanford J. Shaw – Ezel Kural Shaw, History of the Ottoman Empire and modern Turkey, Cambridge, 1976, 399.

¹⁰ Унутрашња политичка криза, “Мисао“ (Књижевно – политички часопис), Београд, 1919, 64.

reparacionet janë problematike. Gjithë kjo skamje që nuk dihej se si ta kompensojnë, bën që sensibiliteti popullor të jetë tepër i lartë. Sigurisht që do të rritej edhe më shumë nga klauzolat për mbrojtjen e minoriteteve. Traktati i Sënt Zhermenit parashikonte në nenin 51 që shteti jugosllav (Mbretëria SKS) të pranojë futjen në një konventë të dy llojeve të dispozitave: së pari, që fuqitë e mëdha aleate dhe shtetet anëtare “(do) të gjykojnë të nevojshme mbrojtjen në shtetin serbo-kroato-sllloven të banorëve që janë ndryshe nga shumica e popullsisë në aspekt të racës, gjuhës dhe fesë”; pastaj, dispozitën tjetër që të njëjtat fuqi “do ta gjykojnë si esenciale mbrojtjen e lirisë së transitit dhe një qeveri të drejtë për tregtinë me vendet e tjera”. Para firmosjes së konventës në fjalë, që është pa dyshim pjesë përbërëse e traktatit të Sënt Zhermenit, qeveria jugosllave do të donte të sigurohej që kjo konventë përmban të gjitha dispozitat e shpallura nga traktati, dhe se nuk do të nxjerrë si shfajësim nenin 51 të traktatit për t’i imponuar Mbretërisë SKS, dispozita suplementare. Nga ana tjetër, qeveria e Mbretërisë SKS hidhte propozimin për ndryshimet e mëtejshme në konventën e përgatitur, paragrafi I i nenit II, se mund të jenë miratuar me shumicë të thjeshtë votash. Për çfarë modifikimesh bëhet fjalë?¹¹ Çështja ishte veçanërisht e rëndësishme për faktin së Fuqitë e Mëdha dhe ato anëtare, përfshirë Francën, angazhoheshin për të pranuar ndryshimet që do të vendoste shumica e Këshillit.

Sipas marrëveshjes së Sënt Zhermenit ndërmjet Austrisë dhe fuqive aleate, janë vërtetuar disa pika të cilat i mbrojnë pakicat në Mbretërinë SKS, në Rumani dhe në Greqi, që dallojnë për nga feja, gjuha dhe etnia. Atëbotë, nëpër shtetet që kishin probleme të tilla, ishte folur dhe ishte shkruar shumë me anë të shtypit dhe pas disa ndryshimeve, të drejtat e pakicës ishin pranuar nga të gjitha palët. Sipas këtyre përcaktimeve, pakica që jeton në kufirin e cilitdo prej këtyre shteteve, kishte të drejtë që të hapë shkolla të tyre kombëtare për të ruajtur gjuhën dhe për të ruajtur pavarësinë e saj fetare dhe shoqërore¹².

Sipas kësaj, edhe pakica që jeton në Serbinë Jugore (trevat verilindore) dhe dallon prej banorëve tjerë për nga feja, gjuha dhe etnia, i gëzon këtë të drejtë. Mirëpo, gazeta serbe “Demokratija”, organ i Partisë Demokratike që dilte në Beograd, në numrin e saj të 27 janarit,

¹¹ Për këtë pikë qeveria austriake u kishte parashtruar një pyetje aleatëve dhe kishte marrë këtë përgjigje: “Nëse do të ketë vështirësi në zbatimin e këtyre klauzolave, modifikimi i tyre do të thjeshtohet me një marrëveshje që do të miratohej nga shumica e Këshillit të Lidhjes së Kombeve”; ДАРМ, МФ – 1918, фонд. Библиотека и Архив на Друштвото на Народите - Женева.

¹² “Демократија и Маџине“, “Хак“, бр.6, Скопје, дт.11.02.1921, 1

në artikullin me titull “Mbrojtja e pakicave”, mes tjerash shkruante: *“Banorët e Serbisë Jugore nuk dallojnë nga pjesa tjetër e popullit serb as në gjuhë, as në fe, as në etni. Kjo është një e vërtetë e padyshimtë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të praktikohet marrëveshja e mbrojtjes së pakicave”!* Gazeta “Hak” komentonte qëndrimin e shkruesit të këtij artikulli, dhe potenconte se jo vetëm që nuk është i saktë, por në të njëjtën kohë është edhe jologjik, për shkak se qëllimi i tij është që të dëshmohet se si në viset e Serbisë Jugore nuk ka elemente tjera përveç atij serb. *“Demokratija” që ishte organ i një partie politike dhe shkruesi i artikullit me siguri e di se në këto vise jetojnë një milionë myslimanë, të cilët kurrsesi nuk i takojnë popujve sllavë. Nëse mendon që me këto t’i mashtrojë disa qarqe dhe që këtë milion të banorëve ta lë pa të drejta, ai mashtrohet keq, sepse nuk mund të gjendet dikush që do të mund t’i besojë një logjike të këtillë dhe kështu, po ky milion banorë me zërin e tyre, me fenë, traditën dhe me historinë është në gjendje që përherë t’i hedhë poshtë këto botëkuptime demagogjike. Myslimanët të cilët jetojnë në Serbinë Jugore dhe të cilët i takojnë kombësisë turke dhe shqiptare e të cilët flasin me gjuhë të njëjtë dhe janë qytetarët më besnikë të Mbretërisë SKS, qysh gjatë Konferencës së Londrës i kanë fituar të drejtat e tyre. Me marrëveshjen e nënshkruar në Sënt Zhermen, këto të drejta prapë i janë pranuar dhe i janë vërtetuar, ndërsa vetë Mbretëria SKS, duke ua dhënë kushtetutën këtyre viseve e ka pranuar ekzistencën e tyre politike. Sipas kësaj marrëveshje dhe pranimi shihet se njëra pakicë jeton në këto vise: dhe sipas kësaj, hidhet poshtë mendimi i “Demokratija”. Më tej në këtë reagim të gazetës “Hak” potencohet se: “Këtu duhet të veçohen myslimanët në këto vise me traditat e tyre shumëshekullore, po ashtu edhe shqiptarët që janë një ndër popujt më të vjetër në Gadishullin Ballkanik, dëshmi e së cilës është historia dhe rezultatet historike të këtij hulumtimi që e vërtetojnë këtë mendim; ndërsa ekzistojnë edhe dokumente historike që nuk mund të mohohen! Pasi që e gjithë bota e di se në Gadishullin Ballkanik jetojnë myslimanët, kjo është edhe një dëshmi tjetër se autori i artikullit në mënyrë qesharake dhe jologjike e ka mbrojtur një këndvështrim në mënyrë jo të vërtetë e të gabuar. Nëse “Demokratija” mendon se myslimanët në të drejta aspak nuk dallojnë nga serbët dhe se nuk kanë nevojë për marrëveshjen për mbrojtjen e pakicave, edhe kjo çështje meriton kritikë, sepse para se ta kanë këtë mendim, duhet të shikohet se myslimanët me të vërtetë a i gëzojnë të gjitha të drejtat?! Mirëpo, nëse shikojmë paksa më mirë, do të shihet se myslimanët nuk e kanë as të drejtën e tyre natyrore dhe se jetojnë në*

kushte shumë të këqija. “Demokratija” e di pozitën e tyre dhe për këtë shkak, ky këndvështrim bie poshtë. Artikujt që shkruhen me ndonjë plan të caktuar, duhet të mbështeten në argumente të forta”¹³.

Në disa qarqe politike dhe shtetërore, flitej se Italia në Luftën e Parë Botërore, e sidomos pas rënies së Austro-Hungarisë, dëshironte të krijojë një lloj presioni shtetëror ndaj Mbretërisë SKS. Veçanërisht, duke proklamuar se kjo mbretëri nuk e ka respektuar klauzolën e “mosrespektimit”, ka hyrë në konflikt të brendshëm, për t’ia shmangur përkrahjen e aleatëve, dhe në këtë mënyrë ta humbë pavarësinë shtetërore. Sipas disa vlerësimeve, ato ishin kryesisht mendime të baronit Sanino. Që të realizoheshin ato aspirata, ai filloi një fushatë për krijimin e opinionit publik në Sofje, Bukuresht dhe Tiranë, me qëllim që të shpërbëhet shteti i ri i Mbretërisë SKS¹⁴. Italia në Mbretërinë SKS shihte konkurrencën e aspiratave të veta për ndikim në Ballkan dhe insistonte në përmbushjen e pikave nga Marrëveshja e Fshehtë e Londrës e vitit 1915. Ky angazhim i diplomacisë italiane, disa herë i përkeqësoi raportet politike dhe diplomatike me Mbretërinë SKS.

Bullgaria i rishqyrtoi kushtet për paqe, të cilat u dhanë si detyrë t’i plotësojë nga ana e Antantës. Ajo kërkoi prolongimin e afatit që t’i përgjigjet kushteve të kërkuara. Ajo nuk ishte në gjendje t’i pranojë disa nga kushtet, por as nuk ishte në gjendje që të përgjigjej negativisht. Për këtë, që t’u ikë këtyre çështjeve, ajo u thirr në “të drejtën historike”, dhe në dhënien e kontributit nga ana e bullgarëve për vlerat e civilizimit evropian¹⁵. Bullgaria pas Luftës së Parë Botërore, nuk ishte në gjendje që të ndikojë ndaj marrëdhënieve të brendshme të Mbretërisë SKS apo në Ballkan.

Në Konferencën e Paqes së Versajës, shteti i ri i Mbretërisë SKS, u njoh si shtet kombëtar i tre popujve: serbëve, kroatëve dhe sllovenëve. Duke u frikuar nga pakënaqësitë qytetare, një nga qëllimet kryesore të partive udhëheqëse (Partisë Radikale, Partisë Demokratike, etj.), ishte që të formojnë shtet të ri të përbashkët të Mbretërisë SKS, kurse paraprkishte nuk e kishin përcaktuar se a do të jetë ai shtet centralist apo federativ¹⁶. Qeverisja e re e Mbretërisë SKS, ndaj shqiptarëve, turqve,

¹³ По ату.

¹⁴ Унутрашња политичка криза, “Мисао“ (Књижевно-политички часопис), Београд, 1919, 65.

¹⁵ Милан Ђорђевић, Србија и Југославени за време рата 1914-1918, Београд, 1922; Унутрашња политичка криза, “Мисао“ (Књижевно-политички часопис), Београд, 1919, 65-66.

¹⁶ Историја Југославије, Београд, 1972, 427; Јов.М.Јовановић, Стварење зајеничке државе Срба, Хрвата и Словенаца, Београд, 1930, 33.

maqedonasve, dhe popujve të tjerë që kishin mbetur të jetonin në territorin e trevave verilindore, u soll në mënyrë të padrejtë, duke u përpjekur për të shuar të gjitha përpjekjet për manifestimin e ndjenjave kombëtare, duke ua ndaluar që të organizohen politikisht në baza etnike, duke ua ndaluar shkollat në gjuhë amtare, përdorimin e gjuhës në raportet zyrtare, me konfiskimin e tokës, etj., çka negativisht u reflektua në marrëdhëniet mes kolonizatorëve¹⁷ si dhe shqiptarëve, boshnjakëve dhe turqve. Reforma agrare dhe kolonizimi në trevat lindore u vlerësuan si çështjet më madhore dhe më të shenjtat e institucioneve të reja shtetërore.

Traktati i Sent Zhermenit parashikonte në nenin 51 që Mbretëria SKS të pranojë futjen në një konventë të dy llojeve të dispozitave: së pari, që fuqitë e mëdha aleate dhe shtetet anëtare “(do) të gjykojnë të nevojshme mbrojtjen në shtetin serbo-kroato-sllloven të banorëve që janë ndryshe nga shumica e popullsisë në aspekt të racës, gjuhës dhe fesë”; pastaj, dispozitën tjetër që të njëjtat fuqi “do ta gjykojnë esenciale mbrojtjen e lirisë së transitit dhe një qeveri të drejtë për tregtinë me vendet e tjera”. Para firmosjes së konventës në fjalë, që është pa dyshim pjesë përbërëse e traktatit të Sënt Zhermenit, qeveria jugosllave do të donte të sigurohej që kjo konventë përmban të gjitha dispozitat e shpallura nga Traktati, dhe se nuk do të nxjerrë si shfajësim nenin 51 të traktatit për t’i imponuar Mbretërisë SKS dispozita suplementare.

Nga ana tjetër, qeveria jugosllave hedh aludimin për ndryshimet e mëtejshme në konventën e përgatitur, paragrafi i nenit II, se mund të jenë miratuar me shumicë të thjeshtë votash.

Në periudhën pas Luftës së Parë Botërore, gjatë “shkëmbimit” të popullatës mes Turqisë dhe Greqisë në vitin 1920, rëndësia e çështjes fetare në përcaktimin e etnitetit u rrit deri në përmasa absurde. Shumë nga turqit e dëbuar nga Turqia, për gjuhë amtare e kishin greqishten, kurse shumë grekë të dëbua nga Azia e Vogël, për gjuhë amtare e kishin turqishten. Edhe Mbretëria SKS bënte terror shtetëror ndaj popullatës myslimane (shqiptarët, turqit dhe boshnjakët), që të largoheshin nga vatrat e tyre shekullore¹⁸.

¹⁷ Чедомир Митриновић, Колонизација јужних крајева, Београд, 1939, 13; Милан Обрадовиќ, „Аграрни односи на Косово 1918 - 1941“, Југословенско историско списание, Белград, 1978, 425.

¹⁸ Kurta Hielschera, Kraljevina Srba, Hrvata i Slovenaca, Skopje, 1928, 5-7 ; Serge Metais, Historia e shqiptarëve, Tiranë, 2006, 280.

Mbretëria SKS tentonte që në forma të ndryshme ta zvogëlojë numrin e popullatës myslimane, dhe ta thyejë bashkimin etnik (te shqiptarët) dhe fetar në territoret e veta. Për ato arsye, janë ndërmarrë masa drastike të natyrës ekonomike, sociale dhe politike, si kolonizimi, asimilimi dhe dëbimi i dhunshëm. Për këtë, elitat politike serbe vendosën që aspiratat e tyre t'i realizojnë me dëbimin e mijëra shqiptarëve me përkatësi fetare myslimane për në Turqi¹⁹. Në të njëjtën kohë, elitat politike serbe, filluan ta zbatojnë “reformën agrare” që të bëjnë kolonizimin me sjelljen e serbëve dhe malazezëve në trevat verilindore shqiptare.

Jeta politike në Mbretërinë SKS, karakterizohet me ekzistencën e shumë partive politike, e para së gjithash duhet theksuar organizimi rajonal i atyre organizatave në aspekt të fushëveprimit politik, si dhe lufta e tyre e përbashkët politike për pushtet. Në trevat lindore, në periudhën e viteve 1919-1925, jeta politike është zhvilluar kryesisht nëpërmjet luftërave të partive politike, numri më i madh i të cilave e reflektonte konglomeratin e forcave shoqërore, përbërjen shumënacionale të popullatës, stihinë e pronarëve të vegjël, ekonominë e pazhvilluar si dhe masën jo mjaftueshëm të diferencuar të klasave e cila gjendej në trazira politike²⁰.

Mbretëria SKS e porsaformuar, pas vitit 1918, paraqiste jo vetëm se një konglomerat në aspekt nacional e social, por edhe një përzierje të madhe shikuar në aspektin nacional dhe fetar. Në trevat lindore, nga të gjitha partitë politike qytetare, dy nga më të rëndësishmet ishin Partia Radikale dhe Partia Demokratike, të cilat pandërprerë udhëhiqnin me pushtetin shtetëror, me një politikë e cila ishte në interes të të gjithë partive qytetare serbe. Përkaj partive politike qytetare serbe, në trevat lindore vepronte edhe Partia Komuniste e Jugosllavisë dhe Partia Socialiste, të cilat ishin mjaft aktive dhe bartëse të lëvizjes komuniste dhe socialiste, ndërsa vepronin nëpërmjet organizatave të formuara partiake. Në formimin e jetës politike, një ndikim të caktuar politik kishte dhe organizata politike e myslimanëve Xhemijeti, e cila sipas programit, gjatë veprimit të saj disavjeçar, në vitet e para ishte ndërtuar në bazë të parimeve fetare²¹.

¹⁹ Đ.Krstić, Kolonizacija u Južnoj Srbiji, Sarajevo, 1928, 5, 82; Ali Hadri, Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1918-1941), “Gjurmime albanologjike”, nr. 2, Prishtinë, 1968, 167; Mark Krasnići, Savremene društveno - geografske promene na Kosovu i Metohiji, Priština, 1963, 25-26.

²⁰ Надежда Цветковска, Политичките партии во парламентарните изборни борби во Вардарскиот дел на Македонија 1919 - 1929, Скопје, 2004, 27, 6.

²¹ По ату, 30-33.

Reforma agrare dhe kolonizimi në trevat lindore

Një nga mekanizmat për kolonizimin territoreve që dikur ishin në përbërje të Perandorisë Osmane, e që pas Luftës së Parë Botërore hynë në kuadër të Mbretërisë SKS, ishte reforma agrare, përmes të cilës u realizuan aspiratat ekspansioniste të borgjezisë serbe. Kjo politikë ishte zbatuar në trevat lindore, në Kosovë dhe Sanxhak, të ashtuquajtura si “Serbi Jugore”, si dhe në pjesët jugore të Malit të Zi. Qëllimi kryesor i çdo reforme agrare, para së gjithash ishte zhvillimi ekonomik, por këtu u ndërthurën edhe interesa të tjera sociale dhe nacionale²², siç ishin ato në vendet e lartpërmendura, ku u ndeshën këto tre koncepte.

Për zbatimin e kolonizimit në trevat lindore, më 20 shkurt 1914, u soll “Dekreti për popullim”²³. Nga koha e sjelljes së këtij dekreti, e deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore, kishte vetëm se aq mundësi sa të bëhen përgatitjet e para për popullimin në trevat lindore²⁴. Me fillimin e Luftës së Parë Botërore, u ndërpreu edhe përgatitjet për kolonizimin e trevave lindore.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, vazhdoi procesi i kolonizimit në trevat lindore. Për atë qëllim, Qeveria e Mbretërisë SKS, më 25 shkurt 1919 e pranoi draftin e reformës agrare dhe e publikoi më 27 shkurt të atij viti me titull: “Dispozitat paraprake për përgatitjen e reformës agrare”. Këto dispozita paraqitnin bazë ligjore për zbatimin e reformës agrare në Mbretërinë SKS, si dhe për kolonizimin e trevave lindore shqiptare²⁵.

²² Аграрна реформа у Југославији (Експозе Јурја Деметровића Министра Полопривреде, Народном Преставништву, поводом законског предлога о изменима и допунама појединих законских прописа о аграрној реформи), Београд, 1933, 3-6.

²³ Në Nenin 1 të Rregullores për vendosje parashihej edhe autokolonizimi, nëpërmjet blerjes së lirë të tokës. Në Nenin 2 parashihej cilat toka vijnë parasysh për kolonizim dhe mbahej llogari që të mos jenë pronë private, por të jenë shtetërore dhe të “shkreta”. Sipas Nenit 8 të Rregullores, si subjekte të kolonizimit parashihen “vendasit nga hapësirat e porsaçliruara, pastaj qytetarët e kufijve të vjetër të Mbretërisë së Serbisë dhe më pas popullsia serbe dhe sllave nga jashtë vendit”. Në Nenin 11 përcaktohej minimumi prej 5 hektarëve tokë për një amvisëri, dhe nga 2 hektarë për çdo mashkull, anëtarë të familjes, nëse ka mbi 16 vjet, pastaj edhe 3 hektarë për amvisëri që ka vegla dhe bagëti për përpunim të tokës; Александар Апостолов, Колонизација на Македонија во стара Југославија, Скопје, 1966, 37-38.

²⁴ Александар Апостолов, Колонизација на Македонија во стара Југославија, Скопје, 1966, 39.

²⁵ Në “Normat paraprake”, menjëherë në Nenin 1 parashihej pezullimi i raporteve të çifçinjve, ndërsa ndalohej vendosja e raporteve të reja. Çifçinjtë shpallehin si pronarë të lirë të tokës së çifçinjve. Domethënë, sipas Rregullores nga vitit 1914, kolonizimi i paraprante reformës agrare. Praktikisht, kolonizimi filloi të zbatohet menjëherë që nga viti 1919, ndërsa çështja e çifçinjve,

Çështja e kolonizimit të rajoneve jugore (pjesës së Maqedonisë së sotme, Kosovës dhe Sanxhaktut), ishte primare, dhe si e tillë u interesonte partive politike (Radikale dhe Demokratike), si dhe institucioneve shtetërore. Kjo çështje në vetvete ngërthente tre elemente kryesore: elementin politik²⁶, elementin e nevojës së popullimit me njerëz të vendeve pasive²⁷, si dhe elementin financiar²⁸.

Domethënë, që ta rregullojë gjendjen në trevat lindore, një nga qëllimet kryesore të Mbretërisë SKS, ishte zbatimi i reformës agrare dhe kolonizimit. Me këtë reformë, do të realizonte dy qëllime: e para - me likuidimin marrëdhënieve feudale, do të krijoheshin kushte për zhvillimin normal të kapitalizmit, dhe e dyta - përmes sjelljes së kolonëve serbë, do të vendosej baraspesha etnike. Që të realizoheshin këto qëllime, kolonizimit do t'i paraprijë zbatimi i reformës agrare, e cila do ta trasojë rrugën e vërtetë drejt ndryshimit të strukturës së popullsisë në trevat lindore²⁹.

Reforma agrare në trevat lindore, u shfrytëzua si mjet për zbatimin e kolonizimit. Borgjezia serbe, në trevat lindore, Kosovë, Sanxhak e Vojvodinë, këtë e shihte si një masë ekonomike, por edhe si politikë sociale-nacionale për forcimin e rajoneve kufitare³⁰.

Me reformën agrare dhe kolonizimin, u arrit ndryshimi i strukturës etnike në trevat lindore, duke instaluar administratë politike asimiluese ndaj popullatës e cila jetonte në këto territore. Mënyra e kolonizimit të trevave lindore, ishte specifike dhe ndryshonte nga pjesët tjera të Mbretërisë SKS (Sllavoni dhe Vojvodinë). Zbatimi i reformës agrare ishte vënë nga ana e pushtetit si “qëllim nacional” për kolonizimin dhe serbizimin e territoreve të trevave lindore. Ky synim shtetëror për

për arsye të ndryshme përfundimisht do të zgjidhet me Ligin e viteve 1931-33; Aleksandar Apostолов, Колонизација на Македонија во стара Југославија, Скопје, 1966, 62-63.

²⁶ Населџавање у Јужној Србији, “Привредни гласник“, бр.247, дт.29.10.1923, Скопје, 1923, 1.

²⁷ Që me ardhjen e administratës serbe në Maqedoni pas luftërave ballkanike është konstatuar se në të ka “sipërfaqe toke të shkretë dhe të pabanuar”; Aleksandar Apostолов, Колонизација на Македонија во стара Југославија, Скопје, 1966, 34; Населџавање у Јужној Србији, “Привредни гласник“, бр.247, дт.29.10.1923, Скопје, 1923, 1.

²⁸ Населџавање у Јужној Србији, “Привредни гласник“, бр.247, 29.10.1923, Скопје, 1923, 1.

²⁹ Димитрије Богдановић, Књига о Косову, Српска Академија Наука и Уметности, књига.DLXVI, Београд, 1986; Лазар Марковић, Економско - финансијски програм народне радикалне странекe, Загреб - Београд - Љубљана, 1925, 12.

³⁰ Надежда Цветковска, Македонското прашање во Југославенскиот парламент меѓу двете светски војни, Скопје, 2000, 139.

kolonizim ishte inkorporuar edhe në programet e partive udhëheqëse³¹. Shumë herë në periudhën e viteve 1919-1925, reforma agrare shërbeu si shkak për konflikte mes partive politike, por nganjëherë kjo shërbente edhe për afrimin tyre nacional për formimin e shumicës udhëheqëse.

Në fillimet e shtetit të ri, Mbretërisë SKS, reforma agrare ishte në kompetenca të Ministrisë për Politikë Sociale (më 2 prill 1919 ishte emëruar edhe ministri i Reformës Agrare), kurse me dekretin e datës 12.02.1920, ishte themeluar Ministria e Reformës Agrare e Mbretërisë SKS. Në strukturën e saj organizative, Ministria e Reformës Agrare e kishte nën kompetencë departamentin e përgjithshëm dhe atë agrar. Në nenin 27, departamenti agrar solli dekret që në Shkup të formohet Drejtoria Agrare, kurse si organe të saja ekzekutive u formuan rregulloret qarkore agrare, përfaqësitë qarkore agrare dhe komisionet³². Shkupi ishte qendër e Komitetit Agrar, i cili kishte komitetet qarkore në trevat lindore, në Kosovë dhe në Sanxhak.

Pas formimit të Mbretërisë SKS, gjendja ekonomike ishte e rëndë. Ajo ishte kryesisht vend bujqësor dhe 80% e banorëve merreshin kryesisht me përpunimin e tokës. Në një pjesë të saj, e cila më parë gjendej nën pushtetin austro-hungarez, kishin mbizotëruar marrëdhëniet kapitaliste, derisa në pjesën jugore, e cila ishte nën Perandorinë Osmane, ku ndodhej edhe trevat lindore, përfshiheshin rajone të pazhvilluara me marrëdhënie feudale. Inspektori kryesor i Ministrisë së Reformës Agrare, Gjoko Bogojeviq, kishte deklaruar se “pronësia duhet t’i takojë atij i cili e punon tokën”. Sipas tij, organet shtetërore, në plan të parë duhet ta kenë zbatimin e shpejtë të reformës agrare dhe kolonizimit, në territoret ku elementi serb është më i vogël³³. Kjo gjendje ishte në llogari të politikës serbe, e cila përmes reformës agrare donte të zbatojë kolonizimin e trevave lindore.

³¹ Чедомил Митриновић, Колонизација Јужних Крајева, Београд, 1939, 3-4; Лазар Марковић, Економско - финансијски програм народне радикалне странке, Загреб - Београд - Љубљана, 1925, 12.

³² Сектори i përgjithshëm kishte për detyrë t’i koordinojë të gjitha detajet e implementimit të reformës agrare. Сектори agrar kishte 6 njësi, ndërsa njëri prej tyre ishte “Njësia e kolonizimit, riatdhesimit dhe vullnetarëve”. Kjo njësi kishte për detyrë që të kryejë zhvendosjen nga hapësirat e varfra dhe të mbipopulluara në hapësira të përshtatshme për vendosje, ta ndihmojë vendosjen e elementëve vendas nga vendet e huaja dhe të kujdeset për riatdhesimin e të zhvendosurve, të kujdeset për ndarjen e tokës vullnetarëve; Александар Апостолов, Колонизацијата на Македонија во стара Југославија, Скопје 1966, 101-102.

³³ Токо Богојевић, Аграрна реформа, Јубиларни Зборник живота и рада Срба, Хрвата и Словенаца 1918-1928, број.198, Београд, 1938, 299-306.

Popullata vendase në trevat lindore, ashpër e kritikoi praktikën e marrjes së tokës nga fshatarët dhe dhënies njerëzve që nuk merreshin me punimin e saj për shkak se të njëjtit u bënë rentierë. U kritikua edhe mbajtja e marrëdhënieve të çifligjeve dhe pagesa e hakut. Me politikën e keqe agrare dhe kolonizuese, u krijua një lloj padurimi në mes të popullatës vendase dhe kolonëve, prandaj vendasit thoshin se: “Disa bejlerë shkuan, të tjerë erdhën!”³⁴

Është e njohur që në periudhën e Perandorisë Osmane, bashkësitë fetare ishin të privileguara, për shkak se kishin pasuri të mëdha. Me krijimin e Mbretërisë SKS, dhe posaçërisht me proklamimin e reformës agrare, ato duhej të viheshin në shërbim të zbatimit të kësaj reforme. Në këtë drejtim, Kisha Ortodokse Serbe, ishte e privileguar, dhe ajo u vu në shërbim të kolonizimit të trevave lindore. Kisha Katolike e përkrahte zbatimin e reformës agrare, dhe ishte në gjendje që një pjesë të pasurive që i zotëronte “për ndarje të drejtë”, t’i vë në shërbim të shtetit³⁵. Bashkësisë Fetare Myslimane, e cila gjatë kohës së Perandorisë Osmane kishte shumë pasuri të patundshme (vakëfe), me reformën agrare dhe kolonizimin, iu morën shumë prona, duke e dëmtuar dukshëm funksionimin e saj.

Aleksandar Karagjorgjeviqi proklamoi manifestin e tij, në të cilin thuhej: “*Popullit tim, serbëve, kroatëve dhe sllovenëve, duhet t’u njihet barazia qytetare në mbretëri, dhe liritë fetare do të garantohen me ligj*”³⁶. Me këtë manifest, Karagjorgjeviqi dëshironte t’i përfitojë simpatitë popullore të mbretërisë, t’i qetësojë pakënaqësitë ekonomike e politike, dhe me këto hapa, atij iu mundësua konsolidimi i pushtetit. Ky manifest nuk ishte obligues për qeverinë, por partitë politike udhëheqëse, vepruan sipas dëshirës së mbretit, që ta zbatojnë të njëjtin. Për zbatimin e propozimit të Aleksandar Karagjorgjeviqit, u formua një komision i veçantë³⁷, që kishte për detyrë ta konkretizojë dhe zbatojë manifestin e proklamuar. Këtij komisioni i bëheshin presione nga të gjitha anët, për shkak se qëndrimet e partive politike për reformën agrare, ishin të ndryshme dhe secili dëshironte të impononte qëndrimet e veta. Nga ana tjetër, komisioni u angazhua që punën ta kryejë në kohë,

³⁴ Надежда Цветковска, ро ату, 140-141.

³⁵ Владислав Стакић, Аграрни проблеми колонизација и њене тешкоће, “Политички гласник“, година. III, број.78, дт.20.10.1927, Београд, 1927, 10-11; Milovan Obradović, Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941), Priština, 1981, 41.

³⁶ Milovan Obradović, Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941), Priština, 1981, 42.

³⁷ Këtë komision e përbënin Vitomir Koraç, ministër i Punës Sociale, Zh. Petriçiq, ministër i Bujqësisë, dr. Urosh Krul, ministër i Shëndetit Popullor si edhe dr. Mehmet Spaho, si anëtar i përkohshëm.

para mbjelljeve pranverore. Në komision kishte edhe mosmarrëveshje rreth kompensimit të pronarëve të mëdhenj³⁸. Ky komision u formua shumë shpejtë, kurse synimi i tij kryesor ishte që të realizonte premtimet e Aleksandar Karagjorgjeviqit, duke mos marrë parasysh interesat e atyre që kishin prona të mëdha, e të cilët ishin pjesë e reformës agrare dhe kolonizimit.

Me miratimin e Dekretit për popullim (20.02.1914), e deri në fillimin e luftës në mes të Serbisë dhe Austro-Hungarisë, kishte mundësi të bëhen vetëm se përgatitjet e para për popullimin e trevave lindore. Dekreti për popullim ishte shembull i mbajtjes së vazhdimësisë në procesin e zbatimit të reformës agrare. Me këtë u bë vetëm se hapi i parë drejt zgjidhjes së problemeve të sferës së reformës agrare në Mbretërinë e porsaformuar të SKS. Presion të madh ndaj organeve shtetërore për zbatimin e reformës agrare dhe kolonizimit bënte fshatarësia, e cila ishte shumë e dëmtuar nga Lufta e Parë Botërore. Duke u frikuar nga pakënaqësia e masave fshatare, kërkesat të cilat u përkrahën edhe nga klasa punëtore, borgjezia u detyrua të bëjë kompromis vetëm për një shkak - që të mos vijë në gjendje të prishet rendi i ri kushtetuese. Borgjezia nuk pati guxim të del haptas e t'i hedhë poshtë kërkesat e fshatarëve, por me premtimet (të zbrazëta) politike, arriti që ta thyejë revoltën³⁹. Për dallim nga vendet e tjera, reforma agrare i dëmtoi vetëm se pronat e feudalëve, për shkak se shumica prej tyre kishin prona sipas rregullave ligjore maksimaliste. Fshatarët shpresonin se pas likuidimit të marrëdhënieve çifligare, do të fitonin tokë punuese nga pronat e bejlerëve e agallarëve, të cilat i punonin, dhe për këtë arsye edhe e përkrahën reformën agrare⁴⁰.

Në fillim të vitit 1919, kolonizimi u zbatua pa asnjë koordinim, dhe nuk u udhëhoq si duhet nga ana e institucioneve shtetërore. Kolonizatorët në fillim populluan fushat, duke pritur të merrnin pronat ku toka ishte pjellore. Në fillim popullimi bëhej më shumë në mënyrë stihike, për shkak se ndihma dhe stimulimi nga ana e shtetit ishin më të vogla. Kolonët në atë periudhë u infilturuan në trevat lindore pa ndonjë plan të veçantë financiar, kurse qeveria siguronte transferimin e tyre përmes hekurudhës. Në atë periudhë, kolonët u lanë në mëshirë të politikanëve

³⁸ Për pakënaqësitë brenda Komisionit, dorëheqje dha dr. Mehmet Spaho, i cili ishte përfaqësues i pronarëve të mëdhenj; Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, Priština, 1981, 43.

³⁹ Александар Апостолов, *Колонизацијата на Македонија во стара Југославија*, Скопје, 1966, 38-39.

⁴⁰ Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, Priština, 1981, 53.

dhe spekulantëve. Në këtë drejtim udhëhiqnin radikalët, të cilët kishin një qasje arrogante ndaj popullatës vendase, por edhe ndaj kolonëve të rinj⁴¹. Kjo periudhë karakterizohet me konsolidimin e rendit të ri shtetëror, me zgjedhjet lokale e parlamentare, si dhe me miratimin e Kushtetutës.

Toka e konfiskuar me reformën agrare, si edhe toka tjetër e cila hynte në fondin e tokave (kullota, toka të papunuara, etj.), zakonisht u ndahej kolonëve, të cilët në numër më të madh ishin sjellë nga rrethet e tjera të Mbretërisë SKS. Një pjesë e mirë e asaj toke iu dha “punëtorëve kombëtar”, si pensionistëve, xhandarëve, kryeshefave të rretheve, shërbyesve policorë, etj. Pastaj, një pjesë e parëndësishme iu dha bujqve e vendasve, ndërsa turqve dhe shqiptarëve kurrë nuk iu dha asnjë lloj toke⁴².

Në pjesën e Maqedonisë së Vardarit, pronarët e mëdhenj të cilët kishin marrë me qira pronat e bejlerëve, pritnin që kjo çështje do të zgjidhet me ligj, i cili ishte vetëm se një kusht i përkohshëm, i cili zgjati në vitet 1931-1934, kur këto marrëdhënie filluan të zgjidheshin në gjykatat agrare. Këtë gjendje më së miri e shfrytëzuan feudalët e vjetër, të cilët këto prona ua shitën atyre që e punonin tokën. Në trevat lindore, Kosovë dhe Sanxhak, fshatarët e pasur nuk kishin ndonjë përfitim nga reforma agrare⁴³. Mënyra e zbatimit të reformës agrare, ishte shumë komplekse, e përcjellë me paqartësi në zbatimin praktik dhe e eksploatuar për përfitime politike nga ana e partive.

Gjatë marrjes së tokës së myslimanëve, aspak nuk merrej parasysh fakti nëse për ta ajo tokë ishte minimumi për jetë ose jo, nëse bëhej fjalë për oborr, bahçe, etj. Neni 27 i “Dekretit për popullim” të rajoneve jugore, ishte si më poshtë: „*Kur do të matet toka për popullim, në atë rast merret parasysh edhe pronësia private, përkatësisht toka private, dhe nëse pronari dëshmon se është në të drejtë, toka megjithatë do t’i lihet kolonizatorit në shfrytëzim, kurse pronarit të tokës së konfiskuar do t’i jepet tokë në vend tjetër*”⁴⁴.

⁴¹ Александар Апостолов, Колонизацијата на Македонија во стара Југославија, Скопје, 1966, 82; Димитрије Богдановић, Књига о Косову, Српска Академија Наука и Уметности, књига.DLXVI, Београд, 1986; Досадашњи резултати и перспектива будићности колонизације у Јужној Србији, „Стара наша Србија“, бр.1, 19.06.1927, Скопје, 1927, 1.

⁴² Nëse në ndonjë fshat turk ose shqiptar ose në afërsi të fshatit të tillë ishte vendosur ndonjë kolonist, ai paraqiste rrezik të vazhdueshëm për të gjithë ata fshatarë që të shpërngulen, ose t’u merren pjesët e tokës më të mirë; П. Здравковски, Националните малцинства во Народна Република Македонија, “Социјалистичка Зора“, Скопје, 1949, 55.

⁴³ Milovan Obradović, Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941), Priština, 1981, 53.

⁴⁴ П.Здравковски, Националните малцинства во Народна Република Македонија, Социјалистичка Зора, Скопје, 1949, 55-56.

Marrëdhëniet feudale, ligjërisht u eliminuan me nenin 42 të Kushtetutës së Vidovdanit, me të cilën rregulloheshin disa parime, sipas të cilave kryepleqve, çifligarëve dhe në përgjithësi atyre që e punonin tokën në çiflig, i vërtetohej liria e pronës së tokës shtetërore, dhe për të nuk paguanin kurrfarë kompensimi. Toka e punuar e kryepleqve dhe çifligarëve, automatikisht kalonte në pronësi të lirë. Bejlerët, çiflig-sajbitë, si dhe pronarët të cilët e kishin tokën në pronësi, nuk kishin kurrfarë përgjegjësie ndaj kryepleqve dhe çifligarëve. Dëmi nuk ishte i qartë deri në fund. Në Kushtetutë ishte potencuar që pronarët e rinj nuk do ta paguajnë dëmin; kush do ta paguante, si do ta paguante, sa do të ishte çmimi dhe si do të kompensohej, për këto çështje Kushtetuta nuk parashihte asgjë⁴⁵.

Gjatë sjelljes së Kushtetutës, pati debat të ashpër për nenet e Kushtetutës që kishin të bënin me reformën agrare. Debati më i madh u zhvillua rreth pjesës së tretë. Vetë qeveria për këtë çështje nuk ishte homogjene. Qeveria nuk ishte e sigurt deri në fund se mund t'i siguronte votat për miratimin e Kushtetutës⁴⁶. Dallimet për reformën agrare, ndërthureshin brenda në qeveri, ku ky debat i ashpër u transferua edhe në Kuvendin Ligjdhënës. Këto paqartësi dhe mangësi në nenet e Kushtetutës, të cilat kishin të bënin me reformën agrare, veçanërisht çështja e pronave të mëdha, do të shkaktonte kundërthënie të mëdha në mes të pushtetit dhe opozitës parlamentare. Partitë politike, në varësi nga interesi i tyre, kishin qëndrime të ndryshme për reformën agrare dhe kolonizimin.

Këto dy procese (reformën agrare dhe kolonizimin), subjektet politike e eksploatuan mjaft që të përfitojnë sa më shumë vota në zgjedhjet lokale dhe ato parlamentare. Partia Demokratike dhe Partia Radikale, në varësi nga pozita në të cilën ndodheshin, në pushtet apo në opozitë, i shfrytëzuan këto reforma për llogari politike. Në ato rrethana, organizata politike Xhemijeti, dëshironte t'i ruajë interesat e saj politike, duke përfituar më shumë mundësi që të rritej çmimi i pronave dhe që të prolongohej sa më tepër që të ishte e mundur reforma agrare⁴⁷.

Qëndrimi i partive politike ndaj reformës agrare dhe kolonizimit, në mënyrë të drejtpërdrejtë u reflektua në zgjedhjet parlamentare dhe

⁴⁵ Уставни одбор о аграрној реформи, “Мисао“ (Књижевно-политички часопис), књига. II, св. 41-48, Београд, 1921, 134.

⁴⁶ По ату.

⁴⁷ Milovan Obradović, po ату, 55.

në fitimin e mandateve të deputetëve në Kuvend. Në këtë drejtim, Xhemijeti gjatë funksionimit të saj si parti politike, nuk arriti që ta ndërpresë zbatimin e reformës agrare dhe kolonizimit, por përmes kushtëzimeve, arriti që ngadalësojë zbatimin e saj në trevat lindore⁴⁸.

Ndikimi i deputetëve në jetën shoqërore - politike në trevat lindore, ishte aq i madh, saqë organet shtetërore nuk ishin në gjendje që të reagojnë edhe ndaj mosrespektimit të Kushtetutës. Në këtë situatë, shkelësit më të mëdhenj të ligjit ishin deputetët e Partisë Radikale. Forcimi i ndikimit të deputetëve do të jetë edhe më i theksuar në periudhën e fitores së Partisë Radikale në vitin 1920. Përmes të ngarkuarve për zbatimin e reformës agrare, policia dhe organet shtetërore të cilat ishin të dirigjuar nga deputetët radikalë që kishin prona, bëhej presion ndaj maqedonasve, shqiptarëve dhe turqve, të cilëve nga dita në ditë u keqësohej gjendja dhe ekzistenca⁴⁹.

Qëndrimi i Partisë Radikale në lidhje me çështjen e reformës agrare, ishte në përputhje me veprimtarinë e saj politike. I njohur është angazhimi i saj me Kartën e Korfuzit. Me këtë kartë ishte vendosur që çdo emigranti, pjesëmarrës në luftë, t'i ndahen pesë hektarë tokë pjellore në vende të banueshme. Në këtë kartë poashtu parashihej që nëse një ushtar vullnetarë do të vritej, trashëgimtar të jetë familja e tij⁵⁰.

Partia Radikale ishte e detyruar që të merr qëndrim më të fortë ndaj reformës agrare dhe kolonizimit, duke vlerësuar se ky qëndrim do t'i sillte vota në zgjedhjet për Kuvendin ligjvënës. Në konferencën qendrore të radikalëve më 28.09.1920, u konstatua se zbatimi i reformës agrare duhet të jetë në korelacion me kolonizimin⁵¹. Në këtë konferencë u vlerësua se kolonizimi së pari duhet të zbatohet ndaj pronave shtetërore dhe komunale, e derisa ato prona nuk i plotësojnë nevojat e duhura, atëherë duhet të ndahen pronat private. Me këtë tentohej që kolonizimi të zbatohet në territoret e populluara me joserbë. Këto territore kryesisht gjendeshin në trevat lindore, në Kosovë dhe Sanxhak. Në këto vende tentohej që nëpërmjet popullimit, të forcohej elementi serb⁵². Këtu ishte edhe gabimi i radikalëve, të cilët bënë padrejtësi të mëdha ndaj shqiptarëve, turqve dhe bashkësive të tjera, si gjatë reformës agrare, poashtu edhe në domenet e tjera shoqërore, meqë i llogaritnin për qytetarë të

⁴⁸ Vladan Jovanović, Jugoslovenska država i Južna Srbija 1918 - 1929, Beograd, 2002, 74.

⁴⁹ M. Obradović, po aty, 68-69.

⁵⁰ Томо Миленковић, Став Радикалне странке према аграрној реформи 1918 - 1929, Историја XX века, Зборник радова - XI, Београд.

⁵¹ M. Obradović, po aty, 68.

⁵² Po aty, 65-66.

rendit të dytë. Për një periudhë të shkurtër, ende pa mbaruar një vit kalendarik, Ministria e Reformës Agrare, ia arriti qëllimi për popullimin e trevave lindore, Kosovës dhe Sanxhakut, ku u vendosën shumë familje të kolonizatorëve serbë. Sipas të dhënave zyrtare, ai numër arrinte në 2456 familje. Në ato vende, u ndanë pronat e banorëve lokalë - autoktonë, pretendimet e bejlerëve u plotësuan me prona të tjera, derisa tokat më të mira iu ndanë kolonizatorëve⁵³. Kolonizimi në territorin e fushës së Kosovës, fushës së Shkupit dhe Kumanovës, deri në gjysmën e vitit 1922, arriti që t'i plotësojë të gjitha parashikimet nga ana e organeve shtetërore⁵⁴.

Qëndrimi i Xhemijetit për reformën agrare dhe kolonizimin, nuk ishte gjithmonë i njëjtë, për shkak se shpeshherë edhe më herët e shihte interesin personal tek disa funksionarë të vetë, të cilët ishin pronarë të mëdhenj, derisa shumë pak e shihte interesin e përgjithshëm të myslimanëve, diçka që negativisht u reflektua në popull. Qëndrimi i Xhemijetit për këtë çështje u paraqit në Kongresin e Tretë të mbajtur në Shkup, më 14.04.1922. Deputetët e Xhemijetit para kongresit e paraqitën qëndrimin e tyre se pronat nuk kanë asgjë të përbashkët me pronat e çiflig-sajbive, për shkak se marrëdhëniet feudale u ndërprejnë në vitet e 40-ta të shekullit të 19-të⁵⁵. Me këtë qëndrim, Xhemijeti dëshironte ta eliminojë zbatimin e një neni të Kushtetutës, ku parashihej eliminimi i marrëdhënieve feudale, me çka do të legjitimohej kolonizimi i këtyre trojeve.

Conclusion

After 1918, the newly formed Kingdom of SCS, represented not only a conglomerate in national and social terms, but also a great mixture in terms of national and religious. From all the civic political parties in the eastern territories, two of the most important were the Radical Party and the Democratic Party, which continuously ruled with state power, with a policy that was in the interest of all Serbian civic parties. In addition to the Serbian civic political parties, the Communist Party of Yugoslavia and the Socialist Party also operated in the eastern regions, which were quite active and carriers of the communist and social-

⁵³ Колонизација Јужне Србије, "Време", Београд, 28.02.1923, 3.

⁵⁴ ДАРМ, фонд: Македонски Национален Комитет, inv.26.9.932.2671, Закон о наслеђавању Јужних Крајева.

⁵⁵ Питање аграрне реформе, „Јужна Србија“, књ.11, бр.9, Скопље, 16.07.1922, 32.

list movement, while acting through party organizations. In the formation of political life, the political organization of the Muslims, Xhemieti, had a certain political influence, which according to the program, during its operation for several years, in the first years was built on the basis of religious principles.

One of the mechanisms for the colonization of the territories that were once part of the Ottoman Empire, and that after the First World War entered the Kingdom of SCS, was the agrarian reform, through which the expansionist aspirations of the Serbian bourgeoisie were realized. This policy was implemented in the eastern territories, in Kosovo, Sandzak and Macedonia, so-called as "Southern Serbia", as well as in the southern parts of Montenegro. The main goal of any agrarian reform, first of all, was economic development, but here were also combined other social and national interests, such as those in the above-mentioned countries, where these three concepts met.

The most oppressed peoples within this kingdom were the Albanians, Macedonians, Bosniaks and all the smaller peoples who were not a constitutive part of the Kingdom of SCS, such as the Serbs, Croats and Slovenes.

The fate of small peoples was put in danger, therefore they were making efforts for survival. Such an effort was marked by the formation of the Xhemijet party, which gathered around itself the majority of Muslim Albanians, but also other peoples of the Islamic faith.

Recensentë:

Prof. Dr. Zeqirja Idrizi

Prof. Dr. Besnik Rameti

Referencat:

1. Абдули Рамиз - Бислими Музафер, Извештаи на австроунгарски конзули од Македонија за албанските клубови во Македонија, Гласник на Институт за национална историја, 46/1, Скопје, 2002, (Одделен отпечаток).

2. Abdyli Ramiz, Fjalori i Historisë, Shkup, 2008.

3. Андонов - Полјански Христо, Велика Британија и Македонското Прашање на Париската мировна конференција во 1919 година (Избор од документацијата), Скопје, 1973.

4. Апостолов Александар, Предизборната кампања за изборите на Уставотворната Скупштина на Кралството на СХС и теророт во врска со овие избори во Вардарска Македонија низ необјавени документи, “Историја“ Списание на Сојузот на Друштвата на Историчари на СР Македонија, год.XVI, бр.2, Скопје 1980.

5. Banac Ivo, Nacionalno pitanje u Jugoslaviji, Zagreb, 1984.

6. Branislav Gligoriјević, Demokratska stranka i politicki odnosi u Kraljevini Srba hrvata i Slovenaca, Beograd, 1970.

7. Богојевић Ђоко, Аграрна реформа, Јубиларни Зборник живота и рада Срба, Хрвата и Словенаца 1918-1928, бр.198, Београд, 1938.

8. Богдановић Димитрије, Књига о Косову, Српска Академија Наука и Уметности, књига.DLXVI, Београд, 1986.

9. Verli Marenglen, Reforma agrare kolonizuese në Kosovë, Tiranë, 1992.

10. Елезовић Глиша, Трећи конгрес организације муслимана Јужне Србије, “Јужна Србија“, књ.1, бр.4, Скопље, 1922.

11. Здравковски. П, Националните малцинства во Народна Република Македонија, “Социјалистичка Зора“, Скопје, 1949.

12. Malcolm Noel, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë, 2001.

13. Храбак Богумил, Џемијет - Организација муслимана Македоније, Косова, Метохије и Санцака 1919-1928, Београд, 2003.